

1) Fazat e zhvillimit të mendimit shkencor janë :

- Faza e përshkrimit (vrojtuese ) të fenomeneve dhe dukurive
- Faza e qasjes analitike
- Faza e qasjes sistemore

2) Lidhja e sërishme prapavajtëse pozitive synon rritjen e inputeve në funksionimin e sistemit me qëllim të rritjes dhe zhvillimit të tij , nëpërmjet të rritjes së autputeve ,kurse funksioni kryesor i lidhjes së sërishme prapavajtëse negative është që të ruaj gjendjen konstante të sistemit , të nxitë aktivitete qeverisëse dhe të menjanoj ndikimet e teperta të rrethinës të cilat do të shmangin funksionimin e sistemit nga rruga e cila shpie drejt realizimit të qëllimit të caktuar .

3) Cilat janë derivatet e kibernetikes :

Teoria e komunikimit , Teoria e vendosjes , Teoria e programimit , Teoria e LSP-së dhe Teoria e përgjithshme e sistemeve .

4) Çka paraqet Algoritmi ?

Algoritmi paraqet rendin , rregullin dhe teknologjin për zgjidhjen graduale të problemit të caktuar .

5) Entropia maksimale e sistemit është në rastin kur : gjasat e paraqitjes së një ngjarje nga bashkësia e ngjarjeve të mundëshme janë të barabarta .

6) Elementet e sistemit të komunikimit janë :

Burimi i informatës , Koduesi , Kanali komunikues , Dekoduesi , Marrësi i informatës dhe zhurma ose pengesat e jashtme .

7) Sistemi informatik është sistem dinamik artificial dhe kompleks (i hapur)

8) Elementet e sistemit të menaxhmentit të biznesit janë :

Hardveri , Softveri , Baza e të dhënave dhe Personeli

8') Profilat e ekspertëve të nevojshëm në një sistem informatik të menaxhmentit janë:

specialistët për softverin e sistemit , specialistët për bazën e të dhënave , projektuesit , analitikët sistemor , programerët dhe specialistët për hardver .

9) Faktorët të cilët ndikojnë në interaksion midis ndërmarrjes dhe sistemit informatik janë :

Rrethina afariste , Struktura organizative ,Procset afariste dhe Vendorsja menaxheriale .

10) Modelet kryesore të organizimit të bazave të të dhënave janë :

Modeli hierarhik , Rrjetor dhe Relacional.

11) Telematika paraqet : bashkimin e dy teknologjive telekomunikuese dhe informatikës duke krijuar një teknologji të përbashkët .

12) Me rrjetë kompjuterike kuptojmë : ndërlidhjen e dy apo më shumë kompjuterëve në mes veti .

13) WWW paraqet një sistem me standarde të pranuar universale për gjetjen furnizimin dhe paraqitjen e informatave në një rrethinë të kompjuterizuar (world wide web).

14) Trendet e zhvillimit informatik të biznesit janë :

Trendet pozitive (Vendosja e elementeve të teknologjisë informative në një numër të madhë të produkteve dhe shërbimeve , Rritja e ndikimit të teknologjië informative në ndryshimin e marrdhënieve shoqërore dhe prodhuese , Përshtatjen e strategjisë afariste me lloje të reja dhe të përosura të prodhimeve dhe të shërbimeve të teknologjisë informative etj .)

Trendet negative (Rritja e keqpërdorimit të teknologjisë informative , Rritja e kriminalitetit kompjuteristik ose informatik , Zvoglimi i komunikimit personal midis njerëzve dhe Rritja e autokracisë ose e forcës e cila ka si pasojë imponimin e interesave parcialet të individit të shoqërisë së gjërë .

15) Informatika e Biznesit ?

Informatika e Biznesit është shkenca mbi mbledhjen , përpunimin , bartjen dhe shfrytëzimin e informatave me ndihmen e pajimeve teknike në kuadër të sistemit informativ të aplikuar në një rrethinë afëriste .Klasifikimet e informatikës janë :

- a) Prodhuesit e informatave
- b) Përpunuesit e informatave

Created By: ARBER HOTI

- c) Shpërndarësit e informatave
- d) Puntorët e infrastrukturës informative

3- Pyetje mungojnë pasi që nuk më kujtohen

ARBER HOTI